

## DITA BOTËRORE E MJEDISIT JETËSOR 2026

### PËSHPEJTIM I RIPËRTËRITJES SË TOKËS, REZISTENCËS NDAJ THATËSIRËS DHE PËRPARIMIT NË LUFTËN KUNDËR SHKRETËTIRËZIMIT

#### Thirrje globale për veprim në vitin 2026

Dita Botërore e Mjedisit Jetësor (WED) që shënohet çdo vit më 5 qershor është ngjarja më e madhe ndërkombëtare kushtuar mbrojtjes së planetit tonë. E themeluar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1972 dhe e shënuar për herë të parë në vitin 1973 nën sloganin "Vetëm Një Tokë", dita ka qenë një katalizator i madh për ndryshimet ekologjike për më shumë se gjysmë shekulli. E koordinuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor (UNEP) ajo çdo vit mobilizon miliona njerëz nga qeveritë, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore.

Në vitin 2026 bota ndodhet në një pikë kritike ku krizat ekologjike tashmë po e kërcënojnë drejtpërdrejt jetën e përditshme të miliarda njerëzve. Dita Botërore e Mjedisit Jetësor e këtij viti i kushton një theks të fuqishëm tre kërcënimeve të ndërthurura: **degradimit të tokës, thatësisirës dhe shkretëtirëzimit**. Për të gjetur zgjidhje urgjente dhe për ta përshpejtuar ripërtëritjen e burimeve natyrore, ngjarjet qendrore globale në vitin 2026 do të organizohen nga Mbretëria e Arabisë Saudite (me përgatitje që zhvillohen në Riad). Kjo zgjedhje është simbolike, pasi rajoni i Lindjes së Mesme është në vijën e parë të betejës kundër shkretëtirëzimit dhe ekstremeve klimatike.

#### Konteksti historik dhe kriza e trefishtë planetare

Gjatë dekadave Dita Botërore e Mjedisit Jetësor ka evoluar nga një platformë për rritjen e ndërgjegjësimit në një lëvizje për ndryshime konkrete politike dhe ekonomike. Sot, Dita Botërore e Mjedisit Jetësor mbulon një gamë të gjerë temash: nga eliminimi i mbetjeve plastike dhe ruajtja e biodiversitetit, deri te konsumi i qëndrueshëm dhe tranzicioni energjetik.

Kjo qasje pasqyron realitetin e "**krizës së trefishtë planetare**":

- Kriza e ndryshimeve klimatike.
- Kriza e natyrës dhe humbja e biodiversitetit.
- Ndotja dhe kriza e mbeturinave.

Këto sfida ekologjike nuk funksionojnë të izoluara. Ato e përforcojnë njëra-tjetrën dhe rezultati i tyre më shkatërrues është kolapsi i tokës pjellore, që kërcënon ekosistemet dhe sigurinë ushqimore të botës.

#### Tema qendrore për vitin 2026: Fakte dhe parashikime alarmuese

Fokusi i vitit 2026 - **përshejtimi i ripërtëritjes të tokës, rezistenca ndaj thatësisë dhe përparimi në luftën kundër shkretëtirëzimit** - është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj statistikave ekologjike që po bëhen gjithnjë e më alarmante çdo vit.

- **Gjendja aktuale:** Sipas të dhënave të OKB-së, **deri në 40% e tokës së botës është tashmë e degraduar**. Ky proces i shkretëtirëzimit prek drejtpërdrejt rreth **3,2 miliardë njerëz** në nivel global, duke kërcënuar gjysmën e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të botës. Komunitetet rurale dhe fermerët e vegjël që nuk kanë burime për t'u përshtatur janë më të prekurit.
- **Parashikimet për vitin 2050:** Modelet shkencore sugjerojnë se deri në vitin 2050 mbi tre të katërtat (75%) e popullsisë së botës do të preken nga thatësira, e cila mund të shkaktojë migrime masive dhe mungesa të rënda të ujit.
- **Lidershipi Rajonal:** Për adresimin e këtyre çështjeve Arabia Saudite po ndërmerr veprime përmes Iniciativës së Gjelbër Saudite dhe Iniciativës së Gjelbër të Lindjes së Mesme. Për më tepër, presidenca e saj në G20 pa miratimin e Iniciativës Globale për Ripërtëritjen e Tokës, duke ndërtuar një vrull të fortë ndërkombëtar që çoi në Konventën e OKB-së për ta luftuar shkretëtirëzimin (UNCCD) këtë dhjetor.

## **Fuqia dhe përfitimet nga ripërtëritja e natyrës**

Ripërtëritja e tokës ka potencial të madh për t'i kthyer trendet negative ekologjike. Hulumtimet shkencore tregojnë se kthimi i vetëm **15 përqind** të tokës së degraduar në gjendjen e saj natyrore mund të parandalojë deri në **60 përqind të zhdukjeve të pritura të specieve**.

Përfitimet e ripërtëritjes janë të shumta:

1. **Ekzistenca dhe varfëria:** Produktiviteti bujqësor rritet, varfëria zvogëlohet dhe siguria ushqimore përmirësohet.
2. **Ndryshimi i klimës:** Tokat e shëndetshme dhe pyjet e ripërtëritura veprojnë si depo natyrore të karbonit, duke e ngadalësuar drejtpërdrejt ngrohjen globale.
3. **Kushtet ekstreme të motit:** Ekosistemet e ripërtëritura e rrisin rezistencën ndaj stuhive, përmytjeve dhe thatësirave.

Për momentin vendet anembanë botës janë zotuar **të ripërtërijnë një miliard hektarë tokë** (një sipërfaqe më e madhe se Kina). Megjithatë, që kjo të ketë sukses, duhet të ndalen faktorët kryesorë të degradimit. Ripërtëritja e tokës pa i ndalur ndryshimet klimatike është joefektive, kështu që G20 duhet të tregojë lidërsip në të gjithë agjendën klimatike.

## **Roli i arsimit, komunitetit dhe individit**

Për sukses afatgjatë të qëllimeve ekologjike në vitin 2026 edukimi ekologjik konsiderohet një shtyllë kyçe. Integrimi i studimeve ekologjike në kurrikula u mundëson nxënësve të bëhen

qytetarë të informuar që e kuptojnë lidhjen midis aktiviteteve njerëzore dhe natyrës. Njohuritë ekologjike i përgatitin brezat e ardhshëm për të marrë vendime të qëndrueshme.

Në terren, Dita Botërore e Mjedisit Jetësor festohet përmes **aktiviteteve praktike**:

- Iniciativa për mbjelljen e pemëve dhe ripyllëzimin.
- Veprime lokale për pastrimin e mbeturinave.
- Seminare edukative dhe fushata digjitale ndërgjegjësimi.

E përderisa institucionet ofrojnë kornizën, **fuqia e vërtetë i takon individit**. Çdo veprim i vogël ka rëndësi. Përmes zakoneve të përditshme, si zvogëlimi i mbeturinave, kursimi i energjisë dhe ujit, dhe zgjedhja e transportit të qëndrueshëm, çdo person kontribuon në një qëllim më të madh. Në epokën digjitale, mediat sociale e përforcojnë më tej këtë mesazh, duke i motivuar njerëzit të bëhen agjentë të ndryshimit.

## Përfundim

Dita Botërore e Mjedisit Jetësor 2026 e thekson domosdoshmërinë thelbësore të mbrojtjes dhe mbështetjes së planetit tonë. Problemet e degradimit të tokës, thatësirës dhe shkretëtirëzimit nuk janë të pakapërcyeshme, por janë një thirrje e qartë për veprim të shpejtë kolektiv. Zbatimi i përbashkët i njohurive shkencore, ndryshimi i politikave kombëtare dhe transformimi i zakoneve personale mund të sjellin një të ardhme të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Është detyra jonë ta pranojmë këtë thirrje dhe të punojmë së bashku për një planet më të shëndetshëm dhe më rezistent.

## REFERENCA:

- **Geneva Environment Network. (2024).** *World Environment Day: History, Themes and Global Impact*. Geneva: GEN. Достапно на: <https://www.genevaenvironmentnetwork.org/world-environment-day/>
- **Intergovernmental Panel on Climate Change (IPCC). (2019).** *Special Report on Climate Change and Land: An IPCC Special Report on climate change, desertification, land degradation, sustainable land management, food security, and greenhouse gas fluxes in terrestrial ecosystems*. Geneva: IPCC.
- **Saudi Green Initiative (SGI). (2025).** *Combating Desertification and Land Degradation: National and Regional Roadmaps*. Riyadh: SGI Platforms.
- **United Nations Convention to Combat Desertification (UNCCD). (2022).** *The Global Land Outlook (GLO2): Land Restoration for Recovery and Resilience*. Bonn: UNCCD Secretariat.
- **United Nations Environment Programme (UNEP). (2024).** *World Environment Day 2024 / 5 June 2024: Our Land, Our Future*. Nairobi: UNEP. Достапно на: <https://www.unep.org/ietc/news/blogpost/world-environment-day%EF%BD%9C5-june-2024>

- **United Nations Environment Programme (UNEP). (2026).** *Global Action Guide: Accelerating Land Restoration and Drought Resilience*. Nairobi: UNEP / Kingdom of Saudi Arabia Host Committee.

Përgatiti: Departamenti i promovimit të shëndetit dhe i ndjekjes së sëmundjeve